



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë - Akademija Pravde - Academy of Justice

Buletini informativ

- **Aktivitetet e përgjithshme**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)**
- * **Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)**
- * **Aktivitetet për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive**

Shkurt 2023

Aktivitetet e përgjithshme

HRTF - Projekti i ri i Këshillit të Evropës “HELP në Ballkanin Perëndimor”



2-3 shkurt 2023, Beograd – Më shumë se 20 përfaqësues të Akademive Gjyqësore dhe Odave të Avokatëve të Ballkanit Perëndimor, gjashtë përfitues, agjentë qeveritarë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe stafi i Këshillit të Evropës, u mbledhën për dy ditë për të diskutuar rezultatet e veprimet e mëparshme të Programit të Përbashkët Horizontal II të BE/KE-së “HELP në Ballkanin Perëndimor” ku u përcaktuan aktivitetet për projektin e ri dyvjeçar të financuar nga Fondi i Mirëbesimit për të Drejtat e Njeriut (HRTF).

Projekti i ri “HELP në Ballkanin Perëndimor” synon rritjen e kapaciteteve dhe aftësive të profesionistëve ligjorë për zbatimin efektiv të standardeve evropiane kryesisht nëpërmjet formimit profesional dhe arsimimit universitar në nivel kombëtar dhe rajonal. Kurset specifike u identifikuan në bashkëpunim të ngushtë me partnerët e BP-së dhe në koordinim me Departamentin për Zbatimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Takimi u kryesua nga Eva PASTRANA, Udhëheqëse e Divizionit për Trajnim Gjyqësor

dhe të Drejtave të Njeriut, ndërsa pjesëmarrësit u mirëpritën nga z. Këshilli i Evropës.

Kurset HELP mbështesin standardet e Këshillit të Evropës dhe të BE-së (jashtëzakonisht të rëndësishme për BP) dhe janë përshtatur me nevojat ligjore vendase. Ato zbatohen në bashkëveprim me Institucionet për Trajnim të Gjyqësorë dhe Odat e Avokatëve të BP-së, ku disa prej tyre bëhen pjesë integrale e programeve kombëtare të trajnimit dhe të tjera duke përforcuar rrjetëzimin rajonal midis këtyre institucioneve dhe profesionistëve ligjorë. Duke vlerësuar nevojat për trajnim të institucioneve partnere në diskutimet e linjës me përfaqësues nga Agjentët e Qeverisë dhe Departamenti për Zbatim i Këshillit të Evropës, kurset e mëposhtme HELP janë përzgjedhur paraprakisht si prioritet për disa nga partnerët e BP-së.

- Ndalimi i keqtrajtimit
- Standardet e KPT-së
- E drejta për liri dhe siguri
- Alternativat e paraburgimit
- Masat mbrojtëse procedurale në procedimet penale dhe të drejtat e viktimave
- Arsyetimi gjyqësor dhe të drejtat e njeriut
- Etika për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët
- Mbrojtja e të dhënave dhe të drejtat e
- Ligji për familjen dhe të drejtat e njeriut
- Të drejtat e pronës

Akademia e Drejtësisë mirëpriti përfaqësuesin e Departamentit të Drejtësisë së SHBA-ve

Akademia e Drejtësisë me datë 16.02.2023 mirëpriti Këshilltarin e ri Ligjor Rezident nga OPDAT z. Erin Cox dhe z. John P. Moran, ndihmës shef në Zyrën për Arsimim në Departamentin e Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara (DOJ), Zyra e Edukimit Juridik (OLE).

Z. Moran, është caktuar me detyrë për mbështetje të Akademisë së Drejtësisë në zhvillimin e Programit të Trajnimit të Trajnuesve, hartimin e materialeve, udhëzuesve/mësimore për trajnimin

fizik dhe në distancë, metodologjinë dhe proceset e vlerësimit të nevojave dhe ndikimit të trajnimit. Përmes angazhimit të z.Moran OPDAT shpreh mbështetjen e vazhdueshme për Akademinë e Drejtësisë në avansimin e arsimimit ligjor për gjyqtarë dhe prokurorë.



Vizitë studimore e gjyqtarëve të Republikës së Kosovës në Trier dhe Koblenz të Gjermanisë



Nga data 19-24 shkurt 2023, në mbështetje të IRZ-së është realizuar një vizitë studimore në Akademinë Gjermane të Drejtësisë për gjyqtarët e gjeneratës së tetë në trajnimin fillestar.

Pjesë e kësaj vizite ishin z. Vaton Durguti, Kryesues i Këshilli Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, z. Enver Fejzullahu, Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë z. Albert Zogaj, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës si dhe znj. Mejreme Mema, u.d. Kryetare e Gjykatës Supreme.

Qëllimi i kësaj vizite ishte mundësimi i vëzhgimit praktik të metodave të punës në gjykatat gjermane, si dhe shkëmbimi i përvojave dhe

fuqizimi i kontakteve ndërmjet institucioneve të dy vendeve.

Në kuadër të kësaj vizite pjesëmarrësit paten mundësinë e njohjes me rregullimin e sistemit gjyqësor në Gjermani dhe veçanërisht për drejtësinë penale, civile, familjare, çështjet etike, çështjet tregtare si dhe për mundësinë e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve në Gjermani.

Sipas programit të vizitës gjyqtarët vizituan Gjykatën e shkallës së parë në Trier dhe Gjykatën e Apelit në qytetin Koblenz të Gjermanisë dhe për së afërmi u njohën me organizimin dhe funksionimin e tyre duke përfshirë edhe vëzhgimin praktik të një séance gjyqësore. Pjesëmarrës në këtë vizitë ishin 19 gjyqtarë si dhe 2 zyrtarë nga Akademia e Drejtësisë.

Vizita studimore është mundësuar për gjyqtarët e gjeneratës së VIII që kanë përfunduar trajnimin fillestarë në Akademi të Drejtësisë gjatë vitit 2021-2022.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Trajnimi fillestarë për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata (IX)

.Gjatë muaji shkurt janë realizuar 4 sesionet e fundit të trajnimit teorik për dy grupet e gjyqtarëve (45) gjithsejtë.

Pas përfundimit të trajnimit teorik është filluar me zbatimin e trajnimit praktik në gjykatat përkatëse nën mbikëqyrjen e mentorit 10 ditë si dhe me vizitat/trajnimet në 8 institucionet jo gjyqësore.

Për grupin e I është realizuar sesioni i fundit nga moduli E drejta civile administrative dhe ekonomike me theks te E drejta pronësore dhe të drejtat tjera sendore nga i cili janë trajtuar: pengu hipoteka barra sendore dhe e drejta e ndërtimit

Për grupin e dytë të gjyqtarëve janë realizuar 3 sesione trajnimi nga moduli: Kodi i Procedurës Penale ku 1 sesion është realizuar në kuadër të nën modulit: “Provat në procedurën penale” me theks te: kontrolli, këqyrja, kërkesat ndërkombëtare provueshmëria dhe pranueshmëria. Në vijim të këtij moduli edhe 1

sesion nga nën moduli Procedurat e veçanta sipas KPPK dhe 1 sesion nga nën moduli Procedurat alternative me ç rast janë trajtuar procedura për revokimin e dëmeve alternative si dhe lirimi nga dënimi.

Në kuadër të “Programit për trajnime në institucionet jo gjyqësore” për gjyqtarët e sapo emëruar janë realizuar vizita në institucionet si në vijim: “Agjencinë për informim dhe privatësi”, “Institutin e mjekësisë ligjore”, “Policinë e Kosovës”, “Shërbimin korrektues”, “Doganën e Kosovës”, “Shërbimin sporvues”, “Gjykatën kushtetuese” dhe te “Avokati i popullit”.

Në kuadër të këtyre vizitave/trajnimeve, gjyqtarët kanë pasur mundësi të njihen me rolin dhe funksionin e këtyre institucioneve dhe po ashtu të thellojnë bashkëpunimin ndërinstitucional.



Trajnimi fillestarë për prokurorët e sapo emëruar gjenerata (IX)



Gjatë muajit shkurt, për 6 prokurorët e sapo emëruar (1 prej tyre në pushim të lehonisë) janë realizuar 16 sesione trajnimi teorik dhe 12 ditë të trajnimit praktik.

Sesionet e trajnimit teorik ishin nga moduli Kodi i procedurës penale dhe nën modulet: Roli i prokurorit në fazën e shqyrtimit gjyqësor, Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor, Procedurat alternative, Aktakuza procedura e shqyrtimit, Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale si dhe Provat gjatë hetimit.

Nga nën moduli “ Roli i prokurorit në fazën e shqyrtimit gjyqësor ” janë realizuar 4 sesione trajnuese me ç’rast janë trajtuar; Roli i prokurorit të shtetit gjatë shqyrtimit fillestar, roli i prokurorit në shqyrtimin e dytë, roli i prokurorit në shqyrtimin gjyqësor dhe marrja e drejtpërdrejt në pyetje, marrja e tërthortë në pyetje dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit.

Nga nën moduli “ Shqyrtimi fillestar i dytë dhe shqyrtimi gjyqësor ” është realizuar 1 sesion trajnues në kuadër të cilit janë trajtuar aspekte të rëndësishme të shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit gjyqësor

Nga nën moduli “ Procedurat alternative ” janë realizuar 2 sesione trajnuese, me ç’rast janë trajtuar çështje ligjore nga Pezullimi i

përkohshëm i procedurës (neni 320) dhe kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme (neni 231).

Nga nën moduli “ Aktakuza procedura e shqyrtimit ” janë realizuar 5 sesione trajnuese në kuadër të cilave janë trajtuar Ngritja e aktakuzës, të drejtat e të pandehurit pas pranimit të aktakuzës, ndryshimi zgjerimi dhe huthja e aktakuzës, propozimet ndaj kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore nën ndikim të alkoolit dhe drogës dhe aktakuza me propozim për paraburgim.

Nga nën moduli “ Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale ” është realizuar 1 sesion trajnues me fokus të Leximi i procesverbaleve.

Nga nën moduli “ Provat gjatë hetimit ” janë realizuar 3 sesione trajnuese, në kuadër të cilave u trajtuan këto tema: Sigurimi i provave në veprimet fillestare të policisë, sigurimi i provave me anë të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, provat në fazën e hetimeve, bastisjet-kontrolli-sekuestrimi i përkohshëm dhe ekspertizat.

Në kuadër të Programit për trajnime në institucionet jo gjyqësore, prokurorët e sapo emëruar vizituan institucionet si në vijim: “Agjencinë për informim dhe privatësi”, “Institutin e mjekësisë ligjore”, “Policinë e Kosovës”, “Shërbimin Korrektues”, “Doganën e Kosovës”, “Shërbimi Sprovues”, “Gjykatën kushtetuese” dhe “Avokatin e Popullit”.

Në kuadër të këtyre vizitave/trajnimeve, prokurorët kanë pasur mundësi të njihen me rolin dhe funksionin e këtyre institucioneve dhe po ashtu të thellojnë bashkëpunimin ndërinstitutional.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Trajnimi: Dëshmitarët bashkëpunues

Më 01-02 Shkurt 2023 në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Dëshmitarët bashkëpunues”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me institutin e Dëshmitarëve Bashkëpunues në funksion të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore gjatë paraqitjes dhe arsyetimit të kërkesës për dëshmitarët bashkëpunues si dhe gjatë hartimit të marrëveshjes dhe përcaktimin e obligimeve që rrjedhin nga marrëveshja e dëshmitarit.

Në këtë trajnim u elaboruan Risetë e Kodit të Procedurës Penale në lidhje me këtë institut duke vënë në pah rolin e dëshmitarit bashkëpunues, rastet në të cilat mund të fitohet statusi i dëshmitarit bashkëpunues si dhe specifikat tjera të procedurës bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e dëshmitareve. Në ditën e dytë trajnimi është fokusuar në elementet që duhet të përmbajë marrëveshja e bashkëpunimit e dëshmitarit bashkëpunues me prokurorin e shtetit si identitetin e prokurorit të shtetit dhe të dhënat personale të dëshmitarit bashkëpunues, detyrimin e dëshmitarit bashkëpunues për të dëshmuar në cilësinë e dëshmitarit etj. Në vijim vëmendje të veçantë kishte identifikimi i dëshmitarit bashkëpunues

gjatë procedurës penale me theks gjatë procedurës hetimore duke theksuar rolin e prokurorit në këtë drejtim i cili duhet të bëjë identifikimin e dëshmitarit të mundshëm bashkëpunues duke marrë parasysh veprimet e secilit bashkë të pandehur gjatë kryerjes së veprës penale e duke u bazuar në specifikat e secilit nga të pandehurit bashkëkryes e në veçanti veçoritë personale të pandehurve, raportin e tyre, motivin si dhe eventualisht dobësitë e shprehura në raport me bashkë të pandehurit.

Gjyqtarët dhe prokurorët pjesëmarrës në trajnim patën mundësinë e diskutimit të rasteve nga praktika gjyqësore e deri tanishme e me këtë edhe sfidat dhe përparësitë e Kodit të Procedurës Penale në fuq.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 11 gjyqtarë të nivelit Themelor të Gjykatave nga të gjitha regjionet e Kosovës, si dhe 12 prokurorë, prej tyre 1 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 1 nga Prokuroria Speciale si dhe 10 të tjerë nga Prokuroritë Themelore.



Trajnim: Dëmshpërblimi, llojet e tij dhe praktika gjyqësore

Më 01-02 Shkurt 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Dëmshpërblimi, llojet e tij dhe praktika gjyqësore”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me përcaktimin e kërkesave të dëmit material dhe jomaterial, si dhe nxjerrjen e provave relevante lidhur me vërtetimin e bazës juridike.

Për dy ditë me radhë trajnimi është fokusuar në identifikimin e shkaqeve të shkaktimit të dëmit dhe llojet e përgjegjësive për kompensimin e dëmit të shkaktuar, identifikimin e kritereve për caktimin e dëmshpërblimit për dëmin material dhe jo material si dhe për aspektet praktike të caktimit të këtij dëmshpërblimi për të gjitha llojet dhe kategoritë e tij.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar dispozitave ligjore të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve nga neni 136 deri në nenin 193 të cilat rregullojnë marrëdhëniet e detyrimeve jashtë kontraktuese, respektivisht shkaktimin e dëmit dhe çështjet tjera që ndërlidhen më të. Gjithashtu u trajtuan format më të shpeshta të shkaktimit të dëmit në praktikë që zakonisht janë mosrespektimi i kontratës, shkelja e të

drejtave të autorit, shkelja e rregullave të konkurrencës, shkaktimi i dëmit nga mjetet e rrezikshme, dëmi i shkaktuar me veprime të kundërligjshme për të cilat gjykata ka vendosë për shpërblimin e dëmit material dhe jo material.

Gjyqtarët pjesëmarrës patën mundësinë e diskutimit të rasteve të ndryshme të dëmshpërblimit nga praktika gjyqësore në kuadër të cilave fokusi ishte te caktimi i lartësisë së dëmit dhe rrethanat të cilat kanë ndikuar në lartësinë e dëmshpërblimit dhe në zvogëlimin e dëmshpërblimit.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe vëllimit të kërkesës për dëmshpërblim, pra a është kërkuar vetëm dëmshpërblimi i rëndomtë apo edhe fitimi i humbur si dhe specifikat tjera si çmimi i tregut i sendit të dëmtuar, sepse gjykata është e obliguar që dëmshpërblimin ta caktojë sipas çmimit të tregut në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 43 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata Supreme, 8 nga Gjykata e Apelit si dhe 34 nga Gjykatat Themelore.



Trajnim: Programi i trajnimit për hetime financiare dhe Rikuperim të aseteve

Më 06-10 Shkurt 2023, në mbështetje të UNDP/SAEK 3 dhe Institutin e Bazellit për Qeversije në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Hetimi Financiar dhe Rikuperimi i Aseteve”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me gjurmimin e aseteve dhe organizimin e provave me rastin e hetimeve financiare dhe rikuperimit të aseteve.

Në ditë e parë dhe të dytë trajnimi u fokusua kryesisht në trajtimin e aspekteve të rëndësishme të pastrimit të parave, gjurmimit të aseteve, organizimit të provave elektronike dhe elementeve të krimit në kontekst të legjislacionit vendor.

Në ditën e tretë dhe të katërt trajnimi u fokusua në qasjet hetimore financiare me theks te metoda e tërthortë për vërtetimin e të hyrave të paligjshme dhe ndihmën e ndërsjelltë juridike

si dhe në mekanizmat për konfiskim të aseteve. Për katër ditë me radhë pjesëmarrësit patën mundësinë e ushtrimeve praktike për gjurmim të aseteve dhe në këtë mënyrë edhe të diskutojnë problematikat eventuale dhe të shkëmbejnë praktikatat më të mira në rastet përkatëse.

Në ditën e pestë trajnimi u përqendrua në përgatitjet dhe prezantimet e pjesëmarrësve për rastet studimore.

Metodologjia e trajnimit është e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi janë: 10 Zyrtarë policor, 4 inspektor të Inteligjencës nga ATK, 2 bashkëpunëtor profesional nga Prokuroria Themelore Ferizaj dhe Prishtinë, 2 ekspert dhe 1 administrator nga PRSK si dhe ekspert nga Prokuroria Speciale.



Trajnim: Harmonizimi i ndryshimeve të reja të KPP me KDM

Më 07 Shkurt 2023, si rezultat i mbështetjes nga EULEX në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Harmonizimi i ndryshimeve të reja të Kodit të Procedurës Penale me Kodin e Drejtësisë për të Mitur”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me dispozitat e reja të Kodit të Procedurës Penale dhe identifikimi i dispozitave ligjore për harmonizim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Trajnimi u fokusua në mospërputhshmërinë e dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Drejtësisë për të mitur të cilat kanë sfiduar gjykatat dhe prokuroritë në zbatimin praktik. Gjatë trajnimit u elaboruan ndryshimet ligjore të Kodit të Procedurës Penale lidhur me të drejtat e viktimës dhe palës së dëmtuar, mbrojtjen e detyruar dhe me shpenzime publike. Në vazhdim edhe trajtimi i kallëzimeve penale dhe e drejta e palës së dëmtuar ose viktimës për të ushtruar ankesë ndaj vendimeve për hushjet ndaj kallëzimeve penale, masat e veçanta hetimore, marrja në

pyetje dhe marrja e deklaratës në procedurë paraprake, shqyrtimi fillestar dhe ndryshimet tjera më rëndësi.

Është diskutuar edhe lidhur me hushjet e kallëzimeve penale si rezultat i zgjidhjes së rasteve tek të miturit me procedurë të diversitetit apo edhe në rastet e oportunitetit dhe mundësia e të dëmtuarit apo viktimës në parashtrimin e ankesës ndaj hushjes. Po ashtu janë trajtuar çështja e mbrojtjes së të miturve dhe angazhimi i përfaqësuesve ligjor në mbrojtjen dhe përfaqësimin e tyre dhe tema tjera.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 9 gjyqtarë kryesisht të nivelit themelor si dhe 18 prokurorë (1 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 1 nga Prokuroria e Apelit si dhe 16 të nivelit themelor) dhe 1 praktikantë nga prokuroria.



Trajnim: Kontratat dhe anulimi i tyre

Më 08-09 Shkurt 2023, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar Trajnimin me temë “Kontratat dhe anulimi i tyre”.

Qëllimi i trajnimit ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për interpretimin e kontratave në praktikë për vendosjen meritore të rasteve në gjykata kur ka kërkesa për pavlefshmërinë e kontratave dhe kompensimin e dëmit.

Në ditën e parë të trajnimit janë trajtuar kushtet ligjore që duhet të plotësohen për tu konsideruar një kontratë nule dhe e rrzueshme, shkeljet relative dhe absolute të kontratave sipas dispozitave ligjore, kontrata e rrzueshme, shkaqet ligjore të cilat e bëjnë një kontratë të rrzueshme, rrethi i subjekteve të cilët mund të kërkojnë anulimin e kontratave të rrzueshme, procedura kontestimore lidhur me vërtetimin e nulitetit relativ dhe absolut të kontratave si dhe pasojat juridike të anulimit të kontratës relativisht të pavlefshme.

Në ditën e dytë është diskutuar për pozitën e palëve kontraktuese dhe personit të tretë pas anulimit të kontratës relativisht të pavlefshme, afatet kohore ligjore brenda të cilave mund të kërkohet anulimi i kontratave të rrzueshme,

mjetet e sigurimit të ekzekutimit të kontratave, llojet dhe karakteristikat e tyre, kontraktimi i mjeteve të sigurimit dhe mënyra e realizimit të tyre si dhe për procedurën gjyqësore për vendosje në konteste të tilla.

Përmes rasteve praktike janë sqaruar dilema që i referohen konvalidimit apo jo të kontratave mbi shitblerjen e paluajtshmërisë që i’u mungon forma duke u pajtuar njëzëri se këto kontrata nuk mund të konvalidohen, por që raporti i shitblerjes si i tillë gëzon mbrojtje gjyqësore për t’u vërtetuar ekzistimi i tij. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe rasteve të falsifikimit të autorizimit si dhe konceptit të rendit juridik, rregullave të moralit shoqëror, si elemente që një kontratë e bëjnë absolutisht nule.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 44 gjyqtarë, prej tyre 1 nga Gjykata Supreme, 6 nga Gjykata e Apelit si dhe nga 37 të tjerë Gjykatat Themelore.



Trajnim: Risitë e Kodit të Procedurës Penale

Me 10-11 Shkurt 2023, në mbështetje të Ambasadës Amerikane, përkatësisht Zyra e Ndihmës, Zhvillimit dhe Trajnimit Prokurorial të Jashtëm (OPDAT) është realizuar trajnimi me temë “Risitë e Kodit të Procedurës”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte njoftimi i pjesëmarrësve lidhur me Risitë e Kodit të Procedurës Penale, të cilat kanë tendencë për ndryshime të nevojshme dhe efektive.

Trajnimi u orientua në trajtimin dhe shpjegimin sa i përket Mbrojtës së detyruar, mbrojtësi me shpenzime publike dhe kur mbrojtja nuk është e detyruar dhe të drejtat e të dëmtuarit ose viktimës.

Më tej u vazhdua me hedhjen e kallëzimit penal, e drejta për të apeluar aktvendimin, masat e veçanta hetimore, mbrojtja e dëshmitarëve, marrja në pyetje në procedurë paraprake, deklarata në procedurë paraprake, mundësia hetuese e veçantë, hetimi (afati i hetimeve, pushimi dhe rihapja e hetimeve).

Trajtimi i këtyre çështjeve është bërë duke prezantuar sfidat e identifikuar në praktikën e

gjykatave dhe prokurorive.

Në këtë trajnim u trajtua edhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë dhe dëshmitarët bashkëpunues, qasja publike në aktakuzë dhe publikimi i aktgjykimit.

Ndër të tjera u shtjellua edhe Shqyrtimi i dytë, aktakuza e konfirmuar dhe caktimi i shqyrtimit gjyqësor duke u vazhduar me standardin e rishikimit të ankesave shkeljet substanciale, ndryshimi i aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, sekuestrimi dhe konfiskimi si dhe procedura penale ku përfshihen kryesit me çrregullime mendore.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar me raste praktike.

Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin: 15 gjyqtarë (3 nga nga Apeli si dhe 12 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave) 13 prokurorë(1 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, 5 nga PRSK si dhe 7 të tjerë nga niveli themelor) si dhe 10 avokatë.



Trajnim: Programi i Specializuar i trajnimit për dhunën në familje

Më 14 dhe 15 Shkurt 2023, në bashkëpunim me UNDP, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Program i Specializuar i Trajnimit – Dhuna në Familje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte që gjyqtarët, prokurorët dhe akterët tjerë relevantë të avancojnë njohuritë lidhur me dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me hetimin dhe ndjekjen e rasteve të dhunës në familje për vendosjen në mënyrë meritore të rasteve përkatëse.

Për dy ditë me radhë janë trajtuar sfidat në praktikë si në aspektin penal e po ashtu edhe në aspektin civil

Vëmendje e veçantë i është kushtuar praktikës jo adekuate në drejtim të përshkrimit të dispozitivit të veprës penale të dhunës në familje, dështimit për të provuar në mënyrë bindëse veprën penale të dhunës në familje. Gjithashtu u vunë në pah mangësitë e disa vendimeve në procedurë kontestimore për shkak të mungesës së qartësisë së dispozitivit që në fund rezultojnë me vendim të pa përshtatshëm për përmbartim.

Nga diskutimet e përbashkëta u eliminuan disa probleme praktike që i referohen praktikave jo

të mira për mënyrën e marrjes në pyetje të viktimave të dhunës në familje sidomos viktimave të dhunës psikologjike, të provuarit e dhunës në familje, përshkrimi i qartë i veprimeve të kryesve të dhunës në familje, identifikimi i dhunës në familje të shprehur përmes dhunës psikologjike.

Po ashtu pjesëmarrësit patën mundësinë që të njihen për së afërmi me platformën dixhitale LEXDOKS, e cila në të ardhmen përdoruesve do të ju shërbejë të bëjnë hulumtime ligjore dhe qasje të shpejtë në të gjithë dokumentet e legjislacionit dhe praktikës gjyqësore të Republikës së Kosovës, duke i bërë ato elektronikisht të kërkueshme, lehtësisht të qasshme dhe të përshtatshme.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 11 gjyqtarë nga Gjykatat Themelore, 7 prokurorë (1 nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe 6 të tjerë prokurorë nga Prokuroritë Themelore) , 1 zyrtarë për mbrojtjen e viktimave si dhe 1 zyrtarë për shërbimet sociale.



Punëtori-Hartimi i Udhëzuesit për Konfiskimin



Më 15 dhe 16 shkurt 2023, në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane/OPDAT, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar punëtorja për Hartimin e Udhëzuesit për Konfiskim.

Qëllimi i punëtorisë ishte hartimi i Udhëzuesit për konfiskim sipas Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Si fillim pjesëmarrësit e kësaj punëtorie të cilit ishin kryesisht nga radhët prokurorëve që janë njëkohësisht koordinatorë të rrjetit të konfiskimit dhe akterë tjerë relevantë diskutuan për strukturën dhe përmbajtjen e udhëzuesit. Në vijim u pajtuan që udhëzuesi të jetë sa më praktik dhe të përfshijë të gjitha fazat konkrete

që duhet zbatuar në rastet e konfiskimit konform edhe ndryshimeve të reja ligjore të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

Të koordinuar të gjithë bashkërisht në grupe punuese për dy ditë me radhë punuan në hartimin e tij i cili pasi të finalizohet rekomandohet të aplikohet nga të gjithë zbatuesit e ligjit.

Gjatë punëtorisë, Akademia e Drejtësisë konfirmoj angazhimin e saj në ofrimin e trajnimeve për sekuestrim dhe konfiskim në kuadër të cilave pjesë përbërëse do të jetë edhe zbatimi i Udhëzuesit për konfiskim. Në punëtori po ashtu është diskutuar edhe mbajtja e takimeve të rregullta me koordinatorët e rrjetit të konfiskimit.

Pjesëmarrës në punëtori ishin koordinatorët e rrjetit të konfiskimit të Sistemit Prokurorial, përkatësisht 8 prokurorë nga të gjitha regjionet, 1 gjyqtar, 1 zyrtarë i Agjencisë për Konfiskim dhe Sekuestrim si dhe 1 Këshilltar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.



Punëtorja për zbatimin e Ligjit nr. 0L/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale dhe Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumentet publike

Më 21 Shkurt 2023, në bashkëpunim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe EULEX në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar punëtorja me temë “Drejtësia përballë mbrojtjes së të dhënave personale.

Qëllimi i kësaj punëtorie ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor lidhur me Kornizën Kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe zbatimin e drejtë në praktikë nga të gjithë zbatuesit e ligjit.

Me rastin e punëtorisë u diskutua për konceptet themelore të Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Standardet e ndërhuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në këtë fushë; si dhe, për rolin e Agjencisë dhe mbrojtjen gjyqësore.

Gjatë kësaj punëtorie u diskutuan rastet konkrete që kanë ndodhur në gjyqësor dhe roli i gjykatës në mbrojtjen e të dhënave personale. U theksuan situata si duhet të veprojnë gjyqtarët,

prokurorët, apo policia në mënyrë proporcionale, që mos të dëmtojnë hetimet, respektivisht qasjen në dokumentet publike dhe të njëjtën kohë të mbrojnë të dhënat personale. Gjithashtu u diskutuan edhe për raste të caktuara të cilat eventualisht do të mund të përfundonin në gjykate dhe për mënyrën e veprimit të gjykatave përball situatave të tilla, përkatësisht autorizimet e gjykatave për të ofruar mbrojtje në këto raste.

Metodologjia e punëtorisë ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të kësaj punëtorie ishin 1 gjyqtarë, 3 prokurorë, 31 staf administrativ i gjykatave dhe prokurorive të cilit ishin kryesisht nga radhët e zyrtarëve për informim dhe monitorim të mediave, shefa të zyrës për menaxhimin e lëndëve, bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë tjerë, 13 zyrtarë policor si dhe 3 tjerë nga KGJK, Agjencia e Forenzikës dhe Ministria e Drejtësisë.



Trajnim: Procedura sipas lëndës në rivendosje

Më 21 Shkurt 2023, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë “Procedura sipas lëndës në rivendosje”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve për procedurën lidhur me lëndët të cilat kthehen në rivendosje-rigjykim.

Gjatë trajnimit janë trajtuar aspekte të rëndësishme të procedurës duke filluar nga Seanca gjyqësore; Administrimi i provave dhe nxjerrja e provave të reja; Rekomandimet e Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Supreme; Eliminimi i vërejtjeve dhe shkeljeve si dhe Llogaritja e shpenzimeve të procedurës.

Po ashtu u diskutua se me rastin e anulimit, përkatësisht të prishjes së vendimit të Gjykatës së shkallës së parë, nga ana e Gjykatës së shkallës së dytë, lënda me komplet shkresat e lëndës i kthehet të njëjtës gjykatë të shkallës së parë në rigjykim. Lënda mund të prishet edhe nga Gjykata Supreme e Kosovës, si gjykatë e shkallës së tretë. Kur prishet lënda e Gjykatës së shkallës së dytë dhe të parë nga Gjykata

Supreme e Kosovës, kjo gjykatë komplet shkresat e lëndës i kthen të njëjtës gjykatë të shkallës së parë në rivendosje-rigjykim, ndërsa kur Gjykata Supreme e Kosovës e prish vetëm aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, atëherë lëndën me shkresat e saj ia kthen Gjykatës së Apelit të Kosovës në rigjykim dhe vendosje.

Me rastin e këtij trajnimi përmes rasteve praktike janë sqaruar dilemat që i referohen procedurës që duhet zhvilluar gjykata pas kthimit të lëndëve në rigjykim, duke filluar nga caktimi i seancave, ftesat e palëve dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, marrja e provave dhe vendosja e serishme për të gjitha çështjet kontestuese.

Metodologjia e trajnimit ishte e karakterit të kombinuar me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive duke prezantuar edhe raste praktike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 25 pjesëmarrës., prej tyre 24 gjyqtarë (1 nga Apeli dhe 23 të tjerë nga niveli themelor i gjykatave) si dhe 1 prokuror nga Prokuroria Themelore.



Trajnim: Program i Specializuar Trajnimi - Krimi i organizuar- Sesioni I

Me 21-22 Shkurt 2023, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me US-DOJ/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme ka realizuar trajnimin me temë “Program i Specializuar i Trajnimit Krimi i Organizuar – Sesioni I”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me veprat penale të krimit të organizuar dhe zgjidhja zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi në rastet përkatëse.

Kornizën ligjore ndaj krimit të organizuar dhe tregjet e krimit të organizuar.

Trajnimi në ditën e parë u fokusua në trajtimin e kornizës ligjore ndaj krimit të organizuar dhe tregjeve të korrupsionit, në shkaqet dhe faktorët lehtësues të krimit të organizuar, si dhe infiltrimit të krimit të organizuar në biznese dhe në institucione publike. Për gjitha këto u parashtruan pyetje dhe njëkohësisht përgjigje nga pjesëmarrësit duke ofruar zgjidhjet ligjore adekuate në rastet përkatëse.

Në ditën e dytë, trajnimi u fokusua në ndërlidhjen ndërmjet krimit të organizuar, shpëlarjes së parave dhe korrupsionit, strategjinë e hetimit të krimit të organizuar dhe teknikat e hetimit, objektivat e të provuarit dhe qasja ekipore në hetimin dhe luftimin e krimit të organizuar. Vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe formave të krimit të organizuar ne grupe dhe format e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale.

Pjesëmarrësit patën rastin e diskutimit të një rasti studimor për krimin e organizuar dhe perspektiva e SHBA-ve në trajtimin e këtij rasti. .

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: 8 gjyqtar kryesisht të nivelit themelor si dhe 9 prokuror, 1 prej tyre nga Zyra e Prokurorit të Shtetit, 3 nga Prokuroria Speciale, 1 nga Prokuroria e Apelit dhe 4 të tjerë nga niveli themelor.



Trajnim: Procedura gjyqësore me rastin e gjykimit me merita në procedurën e konfliktit administrativ



Më 23 shkurt 2023, me përkrahjen e GIZ-it gjerman në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Procedura gjyqësore me rastin e gjykimit me merita në procedurën konfliktit administrativ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve dhe zyrtarëve shtetëror lidhur me rolin dhe rëndësinë e procedurës gjyqësore në konfliktin administrativ dhe zbatimin e drejtë të legjislacionit në fuqi në procedurën përkatëse.

Në pjesën e parë u trajtuan: dispozitat ligjore për procedurën e konfliktit administrativ, objekti i konfliktit administrativ; specifikat e seancës së shqyrtimit kryesor (Procedura e provave, Vlerësimi i propozimeve për ekspertizë nga palët ndërgjyqëse, Caktimi i ekspertizave sipas detyrës zyrtare). Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan rëndësia e vendimeve të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore; dhe Zbatimi i drejtë i dispozitave të procedurës së konfliktit administrativ veçmas procedurës sipas mjeteve juridike.

Gjatë trajnimit fokusi ishte në problematikat, sfidat dhe zgjidhjet, me rastin e vendosjes meritore të çështjeve në procedurën e konfliktit administrativ. Pas debatit u ofruan zgjidhje praktike të bazuara në ligj të cilat do të lehtësojnë punën e gjyqtarëve në procedurë me rastin e gjykimit të këtyre çështjeve. Trajnimi

gjithashtu u përqendrua në procedurën e inicimit të konfliktit administrativ, zhvillimit të kësaj procedure dhe përfundimi i sajë në të tre instancat gjyqësore dhe se si zhvillohet e njëjta në gjykatën kompetente kundër vendimeve përfundimtare administrative të organeve publike të qeverisjes shtetërore në Kosovë.

Në trajnim u konkludua se Gjykata vendosë në seancën e shqyrtimit kryesor në çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurës administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do ta anulon me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ.

Gjatë zhvillimit të këtij trajnimi u identifikuan çështjet të cilat kanë shkaktuar vështirësi me rastin e gjykimit në konfliktin administrativ, të njëjtat u adresuan përmes shpjegimeve duke u bazuar në raste praktike dhe shembuj konkret të cilat paraqiten në procedurat gjyqësore gjatë vendosjes së lëndëve konkrete.

Përmes diskutimeve dhe shkëmbimit të përvojave gjatë punës së gjyqtarëve u diskutua edhe për rregullat kryesore të kësaj procedure sipas LKA-së, por veçmas për specifikat të cilat i përmban procedura e gjykimit të rastit në merita.

Ishte një trajnim me karakter praktik i shoqëruar me diskutime nga pjesëmarrësit si dhe shkëmbim të mendimeve dhe qëndrimeve të kundërta.

Zyrtarët e institucioneve pjesëmarrës, gjatë gjithë diskutimeve kanë shtruar pyetje dhe dilema që hasin gjatë në punën e tyre të përditshme e njëkohësisht kanë marrë sqarime dhe përgjigje me dobi nga trajnuesit. Njëkohësisht, në këtë tryezë janë paraqitur edhe qëndrimet e institucioneve pjesëmarrëse, kur janë palë në procedurën administrative dhe

procedurën e konfliktit administrativ.

Pjesëmarrës në këtë tryezë ishin 10 pjesëmarrës, prej tyre 5 gjyqtarë nga Departamenti për Çështje Administrative, Departamenti i përgjithshëm dhe Gjykata Komerciale, 4 inspektor dhe 1 zyrtarë ligjor nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (Inspektoratit të Mjedisit, Ujërave, Natyrës, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit).

Trajnim: Ndërmjetësimi

Më 28 shkurt 2023, në mbështetje të Programit të USAID-it - Drejtësia Komerciale, implementuar nga DEXIS, në kuadër të trajnimeve të vazhdueshme është realizuar trajnimi me temë: “Ndërmjetësimi në aspektin Civil”, për gjyqtarët dhe ndërmjetësit e regjionit të Prishtinës dhe Mitrovicës.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me ndërmjetësimin në aspektin civil dhe zbatimi i saj në praktikë si metodë alternative e zgjidhjes së kontesteve në rastet e mundshme për përmbushjen e nevojave të palëve dhe njëherësh zvogëlimin e numrit të lëndëve të grumbulluara në gjykatë.

Gjatë këtij trajnimi përmes rasteve praktike u trajtuan aspekte të rëndësishme të referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura e aprovimit ose anulimit të marrëveshjeve të ndërmjetësimit, procedura e ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit si dhe

ndërmjetësuesi, roli dhe përgjegjësia e tyre.

Pjesëmarrësit e trajnimit nga të dy regjionet patën mundësinë e diskutimit të disa kontesteve që janë të përshtatshme për tu zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit, si dhe për disa nga lëndët e tjera për të cilat parashihet ndërmjetësimi i detyrueshëm. Vëmendje e veçantë i është kushtuar referimit të lëndëve në procedurën e ndërmjetësimit që është në diskrecionin e gjyqtarëve duke mos anashkaluar vullnetin e palëve në kontest dhe në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore.

Metodologjia e zbatuar ishte e karakterit të kombinuar, me shpjegime teorike dhe diskutime interaktive.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 8 gjyqtar, 4 bashkëpunëtorë profesional si dhe 12 ndërmjetësues nga regjioni Prishtinës dhe Mitrovicës



Trajnimet për bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor të gjykatave dhe prokurorive

Aktakuza dhe shqyrtimi fillestar

Më 28 Shkurt 2023, në kuadër të trajnimeve për bashkëpunëtorët profesional dhe zyrtarët ligjor të gjykatave dhe prokurorive është realizuar trajnimi i radhës nga Moduli Bazik-aspekti penal procedural me temë “Aktakuza dhe shqyrtimi fillestar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e kapaciteteve profesionale e bashkëpunëtorëve profesional në hartimin e drejtë të aktakuzave dhe shqyrtimin fillestar në përputhje me dispozitat ligjore.

Trajnimi në fillim u fokusua në kornizën ligjore vendore dhe nga perspektiva e KEDNJ-së sa i përket aktakuzës me theks te elementet që duhet pasur në konsideratë gjatë hartimit si emërtimi ligjor i veprës penale, provat që duhet prezantuar dhe arsyetimin.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar rasteve kur ngritja e aktakuzës bëhet pa zhvillim të hetimeve dhe rasteve kur ngritja e aktakuzës bëhet pas zhvillimit të hetimeve. Për cilëndo qoftë u theksua që prokurori vjen në konkluzionin se provat e ligjshme që ka siguruar krijojnë dyshimin e bazuar të mirë se vepra penale është kryer dhe kryerësi i asaj vepre penale është vetëm i pandehuri. Në

vazhdim u theksuan edhe raste kur ka pasur hetim të veçantë dhe që në aktakuzë duhet të konstatohen edhe emrat e gjyqtarëve që kanë përbërë kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë, pasurinë nëse propozohet nga gjykata të konfiskohet, provat mbi bazën e të cilave mbështetet baza e konfiskimit, propozimin për paraburgimin, apo edhe lirimin nga paraburgimi nëse i akuzuari gjendet në paraburgim.

Gjatë trajnimit është shqyrtuar edhe aspekti i kontrollit formal të aktakuzës, procedura për ngritjen e aktakuzës dhe shqyrtimit fillestar i cili duhet të caktohet brenda 30 ditëve nga ngritja e aktakuzës.


Në pjesën e dytë, pjesëmarrësit patën mundësinë e ushtrimit praktik të hartimit të aktakuzës bazuar në rastet hipotetike të ofruara dhe në këtë mënyrë me rekomandimet e trajnuesve edhe hartimin e aktakuzave dhe propozimet e dhura ligjore.

Përfitues të këtij trajnimi ishin 24 bashkëpunëtorë profesional dhe zyrtarë ligjor nga gjykata dhe prokuroritë e Kosovës. Prej tyre 4 ishin nga gjykatat dhe 20 nga prokuroritë.




Vijueshmëria në trajnime në PTF përmes grafikoneve

Gjyqtarët e sapoemëruar (gjenerata IX) - Nr. i aktiviteteve të realizuara, Shkurt 2023




Prokuroret e sapoemëruar (gjenerata IX) -Nr. i trajnimeve të realizuara, Shkurt 2023





Vijueshmëria në trajnime në bazë të Instutucioneve-Shkurt 2023



Numri i pjesëmarrjes në trajnime në bazë të Instutucioneve-Shkurt 2023



Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Vijueshmëria në trajnime në PTV e shfaqur përmes grafikoneve



Akademia e Drejtësisë

<https://ad.rks-gov.net>

infoad@rks-gov.net

Rr. "Murat Mehmeti" nr. 1-3, Prishtinë

Tel: +383 38 200 18 660